TRIBUNA SINDIKALE

Qershor 2008

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë





Editorial

DUKE U PERGATITUR PER VITIN E RI AKADEMIK

Ditet e fundit te qershorit jane pothuaj edhe ditet e fundit te ketij viti akademik. Gjithe sistemi i arsimit duke filluar ne nivel Ministrie e deri tek drejtorite e shkollave diskuton per arritjet e kesaj periudhe dhe per objektivat e vitit te ri shkollor. Ky diskutim behet edhe ne te gjitha nivelet drejtuese te sindikatave te arsimit.

Per ne, si sindikata, arritjet e ketij viti mesimor qe po mbyllet jane te pandara nga objektivat e vitit te ri mesimor qe vjen, sepse jane pjese e nje procesi te vetem, qe lidhen ngushte me njera tjetren dhe kushtezohen nga njera- tjetra, jane pjese e synimit madhor per reformimin dhe modernizimin e arsimit. Ne kete kuptim, diskutimi qe po behet keto dite me Ministrine e Arsimit dhe Shkences per institucionalizimin e Tryezes se partneritetit social ne te gjitha nivelet, synimi per rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit negocues midis seksioneve sindikale ne qarqe e rrethe dhe DAR e ZA, harmonizimi i dispozitave te Kontrates Kolektive te Punes me Udhezimet e Ministrise se Arsimit dhe Shkences per punesimin e mesuesve me shkolle te mesme pedagogjike dhe shkolla te tjera te mesme profesionale te profilit te mesuesise, perfundimi i draftit per Kodin e Etikes se Mesuesit dhe negocimi me Ministrine e Financave per harmonizimin e kritereve te perdorimit te Fondit te Vecante ne arsim duke respektuar dispozitat e Kontrates Kolektive te nivelit te pare per kete qellim; jane nder problemet kryesore qe kane preokupuar dhe preokupojne sindikatat e sindikalistet, gjithe mesuesit, jane probleme qe mbarten nga ky vit mesimor qe po mbyllet dhe qe perbejne nje sfide te vertete per punedhenesin dhe punemarresit per vitin akademik qe fillon ne shtator.

Institucionalizimi i Tryezes se dialogut social midis sindikatave, duke filluar qe nga niveli i pare, eshte konkluzioni kryesor i Konferences qe u zhvillua nga MASH, MPCSSHB, ne bashkepunim me FSASH e SPASH. Mbledhja e kesaj Tryeze nje here ne cdo 2-3 muaj eshte kusht percaktues per te konsoliduar pervojen e mire qe eshte krijuar ne sektorin e arsimit per zhvillimin dhe rritjen e efektivitetit te partneritetit social, per te ballafaquar zbatimin e detyrimeve dhe pergjegjesive qe ka secila pale. Diskutimi qe behet ne kete faze midis sindikatave dhe MASH ka si synim kryesor rritjen e aftesive dhe efektivitetit negocues ne nivelet e dyta midis seksioneve sindikale dhe DAR/ZA.

Harmonizimi i dispozitave te Kontrates Kolektive te Punes me Udhezimet e Ministrise se Arsimit dhe Shkences dhe permbajtjen e Strategjise se Arsimit Parauniversitar per punesimin ose largimin nga puna te mesuesve me shkolle te mesme pedagogjike apo shkolla te mesme profesionale te profilit te mesuesise eshte nder problemet me shqetsuese per nje mase te konsiderueshme sindikalistesh. Ky problem do te diskutohet keto dite nga drejtuesit e FSASH e SPASH me Ministrin e Arsimit dhe Shkences. Qellimi eshte qe, duke u orientuar nga kerkesat e Strategjise se Arsimit Parauniversitar per nje arsim cilesor publik, per ritjen e nivelit te arsimimit qe ofrojne shkollat publike dhe modernizimin e gjithe sistemit, te mbrohet mbi baza logjike dhe ligjore kategoria e mesuesve me shkolle te mesme pedagogjike e profesionale dhe me kualifikimet perkatese, kunder interpretimeve dhe qendrimeve antiligjore te disa DAR e ZA, qendrime qe motivohen nga subjektivizmi, njeanshmeria, nga pozita partiake apo sindikale dhe ne shume raste korruptive.

Kerkesa e perseritur e FSASH e SPASH per harmonizimin e Udhezimit te Ministrit te Financave Nr. 21 date 18. 7. 2007 per pedoriminm e Fondit te Vecante me dispozitat e Kontrates Kolektive te Punes per motivimin e mesuesve te dalluar dhe shperblimin nga sindikatat deri ne 2 paga per mesuesit qe dalin ne pension u shtrua dhe diskutua ditet e fundit edhe ne Keshillin Kombetar te Punes. Keshilli, ne te cilin pervec pales punedhenese dhe punemarrese bejne pjese edhe 7 anetare te Qeverise, me Vendimin Nr. 1273 date 5.06.2008 mbeshteti njezeri keto kerkesa te drejta dhe ngarkoi Ministrine e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta dhe Ministrine e Arsimit dhe Shkences, qe te bisedojne me Ministrine e Financave per te zbatuar kerkesat e drejta te Sindikatave te Arsimit per perdorimin e Fondit te Vecante me efektivitet dhe ne favor te atyre mesuesve e sindikalisteve qe e meritojne.

Nje hap perpara do te shenoje hyrja ne fuqi e Kodit te Etikes se Mesuesit, per te cilin tani jemi ne fazen kur ka perfunduar drafti perkates dhe po diskutohet per krijimin e institucionit qe do te merret me zbatimin e kerkesave te ketij Kodit.

Organet qendrore te sindiikatave te arsimit jane angazhuar ne procesin e diskutimit te ketyre problemeve me bindjen se zgjidhja e shpejte dhe e drejte e tyre eshte, jo vetem kurorezim i objektivave te ketij viti mesimor, por edhe baze e garanci per vazhdimin dhe thellimin e procesit te reformimit e modernizimit te arsimit ne vendin tone.

PERMBAJTJA

Editorial:
- Duke u pergatitur per vitin e ri akademik 2
- Mbeshtetje e plote per kerkesat e sindikatave te arsimit 3
- Aktivitete te shumta ne kuadrin e Dites Boterore Kunder Punes se femijeve 6
- Insistim per angazhimin e sindikatave kunder punes se femijeve 9
- Konferenca per rishikimin e reformes se projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim" 10
- Takim i rendesishem me perfaqesues te DAR e ZA te Qarkut te Elbasanit 13
- Te reja shkencore dhe Keshilla praktike 15

Kopertina e pare:
Drejtues të sindikatave të disa profesioneve duke diskutuar per parandalimin e punes se femijeve

Kopertina e fundit:
Nga aktivitetet e zhvilluara ne Elbasan, me rastin e Dites Boterore Kunder Punes se Femijeve

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 35
Qershor 2008
Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV

ADRESA :
Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik,Kati i 3-te, Tirane
Tel & Fax + 355 4 225 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891
E-mail: fsash@abcom-al.com
Internet: www.fsash-spash.com

Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, Kryeredaktor

MBESHTETJE E PLOTE PER KERKESAT E SINDIKATAVE TE ARSIMIT

Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te Punes

Ne ditet e para te muajit qershor Keshilli Kombetar i Punes diskutoi mbi zhvillimin e partneritetit social ne sektorin e arsimit ne te gjitha nivelet. Eshte hera e pare qe Keshilli, si organi me i larte i partneritetit social ne vend, perfshine ne axhenden e vet nje diskutim te posacem per nje sindikate dege ose profesioni. Kjo nuk ishte e rastit. Sindikatat e Arsimit, FSASH dhe SPASH, gjate nje periudhe pothuaj dhjetevjecare kane krijuar dhe konsoliduar nje pervoje pozitive ne zhvillimin e partneritetit social, sidomos ne nivelin e pare.

Ne mbledhje, mbi bazen e materialit te paraqitur nga te dy sindikatat e arsimit dhe ne emer te tyre, z. Xhafer Dobrushi nenvizoi aspektet me te rendesishme te veprimtarise se sindikatave per zhvillimin e partneritetit social ne sektorin e arsimit dhe parashtroi disa probleme e kerkesa qe ndikojne ne forcimin dhe konsolidimin e metejshem te marredhenieve punemarres-punedhenes.

Nder te tjera ai theksoi se:

Prej me shume se dhjete vjetesh Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, kane zhvilluar dhe vazhdojne te zhvillojne me punedhenesin e tyre – Ministrine e Arsimit dhe Shkences, MASH, ne disa raste edhe me Qeverine, nje dialog dhe partneritet social konkret dhe efektiv, qe vjen gjithnje duke u konsoliduar.

Deri ne vitin 2000 sindikatat e arsimit ishin perqendruar kryesisht ne kerkesa ekonomike e sociale, qe lidheshin me rritjen e pagave, me permiresimin e kushteve te punes dhe punesimit dhe garantimin e lirive e te drejtave sindikale. Kjo bente qe levizja sindikale ne arsim te zhvillohej kryesisht ne nje drejtim, ne menyre te njeanshme, vetem ne fushen e mbrojtjes se kerkesave dhe interesave sociale ekonomike te anetareve dhe gjithe punonjesve te arsimit. Kjo per ate kohe ishte e kuptueshme, jo vetem per faktin se funksioni kryesor i nje sindikate eshte ai social, por edhe sepse, pa nje konsolidim dhe zgjidhje ligjore te kerkesave me natyre ekonomike e sociale, duke krijuar tradite mepermjet 2-3 kontratave kolektive nje ose dy vjecare, nuk mundesohej zgjerimi i vizionit te FSASH e SPASH per domosdoshmerine e angazhimit dhe te marrjes se pergjegjesive konkrete nga ana e tyre ne procesin e reformimit dhe modernizimit te arsimit. Pikerisht ne kete etape te dyte, qe perkon me vitet 2001-2008, Sindikatat e Arsimit angazhohen aktivisht, me mundesite dhe potencialet e tyre, qofshin ato edhe modeste ne disa raste, ne zgjidhjen e problemeve qe qendrojne sot para shkolles, para gjithe sistemit te arsimit ne vendin tone. Kete angazhim dhe pjesemarrje te sindikatave e gjejme ne diskutimin e te gjitha fazave te Strategjise se Arsimit Parauniversitar, ne hartimin dhe miratimin e kurrikulave, ne hartimin e kerkesave dhe standardeve te reja per kualifikimin profesional te mesuesve, ne kryerjen nga ana e sindikatave te kualifikimit te rreth 150 mesuesve per zhvillimin e oreve ekstrakurrikulare, ne pergatitjen e draftit per Kodin e Etikes dhe sidomos ne kualifikimin dhe mobilizimin e qindra mesuesve per t'u marre konkretisht me nxenesit qe braktisin shkollen ose me ata qe jane ne rrezik per ta braktisur ate. Ne saj te kesaj pune sistematike disa vjecare, me lektore te kualifikuar qe kane sot te dy sindikatat dhe me ndihmen e Federates Nderkombetare te Sindikatave te Arsimit, EI, (ku SPASH e FSASH jane anetare), me ndihmen e Sindikates Holandeze te Arsimit, AOb, dhe te disa sindikatave te tjera europiane, eshte mundesuar ngritja e strukturave dhe kapaciteteve per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, per parandalimin dhe eliminimin e punes se tyre, duke bashkepunuar ngushte me DAR/ZA, drejtorite e shkollave, pushtetin vendor, organet e rendit, shoqatat e prinderve dhe te femijeve, organizatat jo qeveritare, kryesisht ne rrethet qe jane me problematike si Tirana (zona e Kamzes), Fieri, Elbasani, Shkodra, Korca, Durresi, Vlora, etj. Duke angazhuar mesues sindikaliste, te cilet punojne me nxenes konkrete ne menyre individuale, vetem ne keto dy vitet e fundit jane kthyer ne shkolle rreth 550 nxenes, djem dhe vajza, qe e kishin braktisur ate dhe kane dale nga rreziku i braktisjes me shume se 1 900 te tjere.

Zgjerimi i objektit te veprimtarise se sindikatave, angazhimi i tyre edhe ne problematiken e gjere te detyrave per nje zhvillim cilesor te te gjithe procesit te arsimimit, duke nxitur per t'u perfshire me gjallerisht ne kete proces mijera mesues dhe drejtues sindikaliste, e ka bere me te dukeshme nevojen e bashkepunimit dhe partneritetit midis Sindikatave dhe MASH.

Tashme ne tryezat ku zhvillohet dialogu, qofshin keto ne nivele specialistesh apo drejtuesish, nuk flitet me ne pergjithesi, nuk negocohet per kerkesa te vogla apo ceshtje te rendomta. Ajo cka e ben interesant dialogun dhe te pergjegjshem partneritetin nga secila pale eshte shtrimi dhe zgjidhja e kerkesave apo objektivave qe jane perfshire ne Kontraten Kolektive te Punes, ne plotesimet e permiresimet qe mund dhe duhet t'i behen asaj, per ceshtjet me thelbesore sociale ekonomike dhe te modernizimit te sistemit te arsimit.

Angazhimi yne dhe i punedhenesit ne procesin e partneritetit social nuk eshte nje deshire subjektive, e rastit, as e drejtuesve te sindikatave dhe as e titullareve te MASH. Marredheniet

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 3

tona dypaleshe jane ndertuar mbi konceptet e partneritetit social ne nje shoqeri demokratike dhe mbi bazen e kuadrit ligjor perkates te shtetit tone. Midis ketyre koncepteve apo standardeve europiane e legjislacionit shqiptar ka nje lidhje te ngushte. Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise (miratuar me Ligjin nr. 7961 date 12.7.1995, ndryshuar me Ligjin nr. 8085 date 13.3.1996 dhe me Ligjin nr. 9125 date 29.7.2003) eshte mbeshtetur dhe pasqyron, ne pergjithesi mire, standardet bashkekohore te marredhenieve te punes e per rrjedhim edhe te partneritetit social, standarde qe jane perfshire ne Konventat themelore te Organizates Nderkombetare te Punes, ILO, te cilat jane ratifikuar nga vendi yne. Ne baze te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, Konventat Nderkombetare te cfardo natyre qofshin, pra edhe ato te punes, te ratifikuara nga shteti yne, kane fuqine e ligjit, pra jane te detyrueshme per zbatim. Ne Nenin 122, Pika 1 te Kushtetutes thuhet shprehimisht: " Cdo marreveshje nderkombetare e ratifikuar perben pjese te sistemit te brendshem juridik pasi botohet ne Fletoren Zyrtare te Republikes se Shqiperise". Eshte kjo arsyeja qe legjislacioni yne, kur klasifikon perparesine e normave te se drejtes ne fushen e marredhenieve te punes, Konventat nderkombetare te ratifikuara nga Republika e Shqiperise i rendit menjehere mbas Kushtetutes, (Neni 11 i Kodit te Punes).

Ne kete renditje te normave te se drejtes dhe perparesise se tyre, gjithenje sipas nenit 11 te Kodit te Punes, **Kontrata Kolektive e Punes,** vjen menjehere mbas Kodit te Punes dhe akteve te tij nenligjore. Pra eshte nje nga burimet e se drejtes. Eshte e vertete se ligji, lidhur me hierarkine e normave te se drejtes, disponon se " Cdo dispozite qe shkel nje dispozite te nje shkalle me te larte, eshte e pavlefshme. Por ligji disponon gjithashtu se… " jane te vlefshme, vetem ato dispozita qe permiresojne poziten e punemarresit", (pika 3 e nenit 11 te KP). Kjo do te thote se arritjet qe sindikatat kane siguruar me Kontrate Kolektive ne favor te sindikalisteve dhe punemarresve qe ato perfaqesojne nuk mund te anullohen me asnje ligj apo akt nenligjor.

Baza e dialogut dhe partneritetit social ne sektorin e arsimit kane qene dhe jane Kontratat Kolektive te Punes, te cilat, nga njera tek tjetra kane ardhur duke u permiresuar. Ne dispozitat e ketyre kontratave kane gjetur dhe gjejne shprehje me konkrete dhe me te sakte nga ana ligjore kerkesat e sindikalisteve dhe punemarresve dhe angazhimi i partnereve per nje arsim cilesor dhe shanse te barabarta per te gjithe.

Ne **Kontraten Kolektive te Punes te dates 4 korrik 2006, qe i shtrine efektet e saj deri me 31 dhjetor 2009,** kane gjetur zgjidhje te drejte problemet me kryesore qe lidhen me punesimin, levizjet ne pune dhe kushtet e punes, kohen e punes dhe te pushimit, rritjen e pagave dhe persosjen e sistemit te shperblimeve, kualifikimin e mesuesve, lirite dhe te drejtat sindikale, etj., kuptohet ne raport me zhvillimin e reformes dhe zbatimin e Strategjise se Arsimit parauniversitar deri ne kohen kur u negocuan keto kerkesa dhe u nenshkrua kontrata.

Negocimi dhe nenshkrimi i KK te Punes, si shprehje konkrete e partneritetit social, perben nje etape te caktuar, shume te rendesishme, por jo te vetme te ketij partneriteti. Po kaq e rendesishme eshte periudha qe fillon me nenshkrimin e Kontrates e deri ne mbarim te saj dhe qe ka te beje me zbtimin me korrektesi nga secila pale te dispozitave dhe detyrimeve qe kane marre persiper. Tani qe kemi pothuaj 2 vjet pervoje ne kete proces zbatimi, mund te nxjerrim disa konkluzione per angazhimin e partnereve per konsolidimin dhe rritjen e efektivitetit te partneritetit social.

Se pari, disa kerkesa, sic jane vjetersia ne pune e mesuesve dhe motivimi me i mire i tyre, mosha e daljes ne pension te parakohshem etj., akoma nuk jane negocuar, ndersa ka disa dispozita te KK te nivelit te pare qe lidhen kryesisht me marredheniet e punes qe nuk po gjejne zbatim ne nivele te dyta. Per kete **eshte e nevojshme qe grupet negocuese te sindikatave dhe punedhenesit ne nivel specialistesh dhe pastaj ne nivele vendimarrese te institucionalizojne nje tryeze dy ose tremujore**, ku te analizohen moszbatimet, shqetsimet, problemet dhe shkeljet qe jane evidentuar ne procesin e zbatimit te KK te Punes te nivelit te pare, dispozitat qe nuk kane gjetur zbatim dhe te korrigjohen shtremberimet dhe veprimet qe vijne ne kundershtim me kete kontrate nga DAR/ZA. Ne periudhen per te cilen po flasim me shqetsuese jane:

- Veprimet e disa DAR/ZA ne kundershtim te hapur me KK te Punes te nivelit te pare dhe me legjislacionin e punes lidhur me largimin masiv nga puna te mesuesve me shkolle te mesme pedagogjike, ose shkolla te tjera te mesme profesionale te profilit te mesuesise, duke mos zbatuar drejt as Udhezimin nr. 19 date 30.09.2006 te Ministrit te Arsimit dhe Shkences.
- Emrimet ne pune te mesuesve te rinj pa zbatuar kriteret qe permban KK e Punes, perfshire metoden e konkursit, etj.
- Levizjet pa kriter te mesuesve e te drejtuesve te shkollave nga nje shkolle ne tjetren, nga qyteti ne fshat dhe anasjelltas, jo vetem ne fillim, por edhe ne mes te vitit, duke demtuar procesin mesimor, duke ngjallur frike e pasiguri tek masa e mesuesve; ne nje kohe qe ne Konventa, ne legjislacionin tone dhe ne Kontraten Kolektive thuhet qarte se ndryshimi i vendit te punes behet kryesisht me kerkesen e punemarresit per t'i permiresuar atij kushtet e punes e te jeteses dhe vetem ne fillim te vitit mesimor.
- Nxjerrja ne pension te mesuesve te ciklit te ulet dhe te larte te shkolles 9 vjecare dhe mesuesve ne shkollat e mesme nje muaj ose edhe nje jave para se te mbaroje viti shkollor me pretekstin se ne kete date kane mbushur moshen per pension, duke demtuar rende mesimdhenien, duke shqetsuar nxenesit, sidomos ne rastin e nxjerrjes se rezultateve vjetore dhe duke sjelle

edhe nje dem buxhetit te shtetit. Kuptohet se ne keto veprime qe behen me nxitim dhe ne shkelje te rregullave te punesimit jane ne shumicen e rasteve korruptive.

Se dyti, eshte e nevojshme qe partneret ne nivel qendror te punojne me efektivisht dhe ne vijueshmeri per rritjen e kapaciteteve negocuese dhe zbatuese ne nivel te dyte nga ana e DAR/ZA dhe Seksioneve Sindikale ne rrethe, per te menjanuar dhe eliminuar diferencat e ndjeshme qe ekzitojne midis nivelit te pare, (atij qendror), dhe nivelit te dyte. Disa hapa jane marre. Ketij qellimi i



sherbeu Tryeza njeditore qe u organizua nga FSASH e SPASH me mbeshtetjen e MASH dhe MPCSSHB, ku moren pjese zv/ministrat perkates, drejtoret e DAR dhe drejtuesit e Seksioneve Sindikale ne Qarqe. Tryeza diskutoi dhe percaktoi objektiva per zbatimin e legjislacionit te punes, perfshire Kontraten Kolektive dhe forcimin e institucionalizimin e partneritetit social ne nivelin e dyte.

Se treti , zhvillimet e reja ne arsim, sidomos ato qe lidhen me kualifikimin e mesuesve, me angazhimin e tyre cilesor me talentet e reja, me nxenesit me probleme sociale, me ata qe braktisin shkollen ose perbejne rrezik per braktisje, etj., kane shtruar nevojen qe Kontrates Kolektive ekzistuese t'i behen plotesimet dhe permiresimet e nevojshme.

Sindikatat e Arsimit kane partner social kryesor Ministrine e Arsimit dhe Shkences. Por, per natyren qe ka arsimi, kryesisht si sektor publik, per peshen qe ai ze ne buxhetin e shtetit, per rolin qe ai luan ne progresin dhe te ardhmen e shoqerise, ne momente te caktuara e te rendesishme partneri yne eshte edhe Qeveria ose segmente te saj, sic jane Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Ministria e Financave, etj.

Verejtje konkrete sindikatat kane per Ministrine e Financave, e cila nxjerr udhezime per ceshtje te rendesishme, sic eshte rasti i Fondit te Vecante, qe ne sektorin e arsimit eshte afro 1 miliarde leke, pa u konsultuar me partneret sociale, me sindikatat, pa perfilluar dispozitat e KK te Punes ne arsim qe nga viti 2001, dispozitat e te cilave perfshire motivimin e mesuesve te dalluar, shperblimin e mesuesve qe dalin ne pension, etj.,nuk mund te cveresohen me asnje akt nenligjor as akt administrativ sic eshte ne rastin konkret Udhezimi i Ministrit te Financave, qe **ne vend te deri 2 pagave mujore shperblim qe sindikatat kane garantuar per anetaret e tyre kur dalin ne pension,** Udhezimi, pa perfillur Kontraten Kolektive, thote se punedhenesi ne kete rast jep vetem nje page. Te dy keto akte qe permendem, ashtu sic jane formuluar, shmangin transparencen, menjanojne sindikatat ne procesin e shperndarjes se ketyre te ardhurave dhe nxitin shperdorimin dhe korrupsionin ne administrimin e ketyre fondeve, u mohojne sindikatave te arsimit arritjet qe i kane siguruar me lufte sindikale dhe qe nuk lejojne t'u cenohen.

FSASH dhe SPASH, i perfundoi komentet e tij z. Xhafer Dobrushi, i kerkojne Keshillit Kombetar te Punes qe te ndermjetesoje per zgjidhjen me dialog, mbi bazen e Kontrates Kolektive, te shqetsimeve qe ka krijuar Vendimi i Qeverise dhe Udhezimi i Ministrit te Financave per Fondin e Vecante.

Keshilli Kombetar i Punes vleresoi lart vizionin e sotem te sindikatave te arsimit qe shprehet ne angazhimin e tyre me objektivitet jo vetem per mbrojtjen e interesave dhe zgjidhjen e kerkesave te anetareve qe perfaqesojne, por edhe ne marrjen e pergjegjesive per reformimin dhe modernizimin e arsimit. Ministri i Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, z. Koco Barka, i cili kryen funksionin e Kryetarit te KK te Punes, Ministri Drejtesise Elton Alibeaj, Zv/ Ministri i Arsimit dhe Shkences Halit Shamata, Zv/ Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit Stavri Ristani, etj., qe diskutuan ne mbledhje, folen per aspekte konkrete te veprimtarise se sindikatave te arsimit ne mardheniet me Qeverine, Ministrine e Arsimit dhe Shkences dhe Ministrine e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, mardhenie qe mund dhe duhet te merren si shembull nga punedhenesit dhe punemarresit ne deget dhe profesionet e tjera per zhvillimin korrekt, real dhe frytdhenes te partneritetit social, per marrjen e pergjegjesive nga secila pale ne dialog dhe njekohesisht per nje angazhim te perbashket ne arritjen e objektivave te zhvillimit e progresit te shoqerise dhe vendit tone.

Keshilli Kombetar i Punes vendosi njezeri qe te mbeshtese kerkesat qe parashtruan ne mbledhje Sindikatat e Arsimit dhe u angazhua qe, se bashku me sindikatat, te ndermarre hapat e nevojshem institucionale per plotesimin e ketyre kerkesave.

Veprimtari te shumta te FSASH dhe SPASH ne Diten Boterore Kunder Punes se Femijeve

Ne kuadrin, 12 Qershorit, Dites Boterore Kunder Punes se Femijeve, Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences te Shqiperise, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, sivjet, me mire se cdo vit tjeter, qe nga viti 2002, kur Organizata Nderkombetare e Punes, ILO, ka caktuar 12 Qershorin si Diten Boterore te Luftes Kunder Punes se Femijeve, organizuan disa aktivitete, tema kryesore e te cilave ishte "Arsimimi, pergjigja e duhur per eliminimin e punes se femijeve"

Mbledhje e zgjeruar e Komitetit Drejtues Kombetar per Eliminimin e Punes se Femijeve

Ne bashkepunim me Ministrine e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Ministrine e Arsimit dhe Shkences dhe Zyren e ILO-IPEC ne Tirane, u organizua nje mbledhje e hapur e Komitetit Drejtues Kombetar per Eliminimin e Punes se Femijeve, ku moren pjese, pervec anetareve te ketij Komiteti dhe drejtuesve te sindikatave, sindikaliste, mesues, nxenes e prinder, sidomos nga rrethet Tirane, Elbasan e Fier, ku FSASH e SPASH jane duke punuar ne menyre te diferencuar per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve.



Ministri i Punes Kosta Barka, Ministri i Arsimit Genc Pollo, Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Tirane, Etleva Vertopi, drejtuesit e FSASH, Xhafer Dobrushi dhe SPASH, Bajram Kruja, te pranishem ne kete mbledhje, shprehen angazhimet e tyre dhe te institucioneve qe perfaqesojne ne lidhje me parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Ne fjalen e vete, **Ministri i Punes, Zoti Kosta Barka** theksoi:

Kujdesi per mbrojtjen e femijeve dhe te te drejtave te tyre perben nje prioritet te programit te Qeverise shqiptare dhe te Ministrise se Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta. Investimi per femijet eshte investim per progresin dhe te ardhmen e shoqerise dhe te vendit.

Ne Shqiperi, vazhdoi me tej z. Barka, puna e femijeve perben nje ceshtje shoqerore dhe shtetrore te ndjeshme dhe te mprehte. Shfrytezimi i punes se femijeve u evidentua si fenonem ne fillimet e periudhes se veshtire te tranzicionit dhe eshte shoqeruar me fenomene te tjera si papunesia, levizjet e pakontrolluara te popullsise brenda dhe jashte vendit, prishja e struktures se familjes, varferia, trafikimi dhe shfaqje te tjera te kriminalitetit, renia e interesimit per shkollen dhe mosfrekuentimi i saj, etj.

Qeveria ne bashkepunim me organizatat nderkombetare, sindikatat dhe shoqerine civile, kane programuar punen dhe po perpiqen qe te parandalojne dhe minimizojne fenomenin, po synojme qe te sensibilizojme opinionin shoqeror per demet dhe rreziqet qe sjell puna e femijeve. Ne kete kuader, gjate ketyre viteve jane hartuar politika afatmesme dhe afatgjata per eliminimin e shkaqeve qe ushqejne kete fenomen, mbeshtetur ne nje kuader ligjor konkret dhe sidomos ne Konventat e ILO-s Nr. 138 dhe 182; eshte krijuar Komiteti Kombetar per Eliminimin e Punes se Femijeve, eshte ngritur Inspektoriati Shtetror i Punes, qe ka si funksion kryesor kontrollin e sektorit informal te ekonomise ku perfshihet puna e femijeve.

Po keshtu, eshte hartuar dhe po aplikohet me sukses modeli i monitorimit te punes se femijeve direkt ne baze, nepermjet mbeshtetjes financiare dhe teknike te ILO/IPEC. Keto programe perfshije rreth 460 femije, 230 prej te cileve kane dale nga rreziku i praktisjes se shkolles dhe 54 te tjere qe e kishin braktisur shkollen jane kthyer dhe vazhdojne rregullisht arsimin e detyrueshem. Ne 57 raste eshte mundesuar punesimi i prinderve ose pjesetareve te tjere te familjes se femijeve qe me pare punonin ne rruge.

Vleresojme si shume frydhenese, perfundoj z. Barka bashkepunimin me partneret sociale, vecanrisht

marredheniet me te dy Sindikatat e Arsimit, te cilat kane luajtur nje rol te pazevendesueshem ne angazhimin dhe aftesimin e mesuesve per t'iu pergjigjur sfidave per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.


Ministri i Arsimit dhe Shkences, Zoti Genc Pollo, duke pershendetur te pranishmit ne kete takim theksoi:

Ata qe perdorin punen e femijeve shfrytezojne shtresen me delikate dhe te ndjeshme te shoqerise, femijet, duke rrezikuar te ardhmen e gjithe shoqerise. Kjo dukuri, e dhimbshme dhe shume e vjeter ka sot permasa te frikshme. Per shume njerez, puna e femijeve eshte e padukshme, ndersa ka shume te tjere qe nuk duan ta shohin. Te sensibilizosh shoqerine per punen e femijeve, do te thote t'ia besh te njohur kete plage te rende dhe ta shkundesh nga indiferenca.

Sot, pas nje pune rreth 7-vjeçare te implementimit te Programit "Mbi Eliminimin e Punes se Femijeve ne Shqiperi", si bashkepunim i Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta me Programin Nderkombetar per Eliminimin e Punes se Femijeve ILO/IPEC, jane bere perpjekje te rendesishme per ta sjell kete problem prane vendimmarresve dhe politikeberesve si dhe per te sensibilizuar mbare shoqerine per pasojat tejet negative qe ka puna e femijeve. Nuk eshte bere gjithçka dhe mbetet shume per te bere deri sa kjo dukuri te eliminohet teresisht.

Te gjithe e dime, vazhdoi z. Pollo, qe shkaqet e kesaj dukurie jane te shumta dhe komplekse, dhe pikerisht per kete arsye, perqasja ndaj ketij problemi duhet te jete e tille si ne planin ligjor, nepermjet zbatimit te konventave nderkombetare, ashtu dhe nepermjet zhvillimit te programeve qe perfshijne mobilizimin e te gjitha grupeve shoqerore.

Ne kuadrin e politikave te zhvillimit te arsimit, MASH po zbaton projektin "Cilesi dhe Barazi ne Arsim" qe eshte nje nga prioritetet strategjike per vitet 2007-2010, pasi harmonizon objektivat e Qeverise per nje arsim cilesor e per te gjithe me objektivat e strategjise kombetare te arsimit. Qe objektivat e ketij projekti te arrihen per te gjithe nxenesit e sistemit tone arsimor, MASH per here te pare ka realizuar studimin kombetar per "Shkaqet qe favorizojne analfabetizmin dhe masat qe duhen marre ne luften kunder kesaj dukurie". Bazuar ne rekomandimet e studimit eshte hartuar dhe plani i veprimit se bashku me koston financiare qe mbart.



Nder drejtimit kryesore te ketij plani jane: Hartimi i nje plani te veçante trajnimi te mesuesve per punen me nxenesit e margjinalizuar, bazuar ne problemet specifike qe ka gjithsecili, hartimi i nje platforme per çdo DAR apo ZA qe ka femije jashte sistemit arsimor, per terheqjen ne shkolle dhe realizimi i programeve mesimore suplementare, hapja e shkollave me kohe te shkurtuar ne çdo njesi administrative vendore, rikonceptimi i tyre dhe forcimi i kontrollit shteteror mbi to, sigurimi i transportit per femijet me aftesi te kufizuara dhe per femijet e tjere te cilet banojne larg shkolles, ndertimi i dhjete konvikteve te reja per zonat ne nevoje, nga te cilat shtate konvikte jane financuar ne vitin 2008 dhe tre jane planifikuar per vitin 2009. Te ndergjegjshem qe nje numer i konsiderueshem i femijeve qe punojne jane rome, MASH, me mbeshtetjen financiare te UNICEF dhe "Save The Children", ne bashkepunim me "Qendren e Zhvillimeve Humane" (OJF) dhe shoqatat rome, realizoi studimin "Situata arsimore e femijeve rome ne Shqiperi" per mbledhjen e te dhenat statistikore per femijet rome brenda dhe jashte arsimit parashkollor dhe arsimit te detyruar, evidentimin e situates se arsimimit te romeve ne vendin tone, etj.

Tashme MASH, ne bashkepunim me Sindikatat dhe organizatat jo qeveritare, bazuar ne rekomandimet e studimit, ka identifikuar zonat me te ndjeshme ku duhet te nderhyhet dhe ka hartuar plane konkrete veprimi. Heshtjen e femijeve qe punojne, perfundoi Ministri Pollo, te gjithe duhet ta lexojme si nje britme te dhimbshme qe kerkon ndihme, e cila kerkon qe ne te angazhohemi me gjithcka qe kemi ne dore, per ta eleminuar si fenomen dhe per te siguruar nje te ardhme me te mire, per gjithe femijet dhe mbare shoqerine.

Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Tirane, Zj. Etleva Vertopi, vuri ne dukje veprimtarine disavjecare te institucionit qe perfaqeson ne bashkeveprimin dhe mbeshtetjen jo vetem financiare te aktoreve shtetrore e shoqerore qe jane angazhuar per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve ne Shqiperi. Zj. Vertopi nenvizoi posacerisht bashkepunimin e ILO/IPEC me Sindikatat e Arsimit per eliminimin e punes se femijeve dhe shprehi gatishmerine e Zyres qe perfaqeson per ta vazhduar e thelluar me tej kete bashkepunim, ne kuader te

Vijon në faqen 8

Vijon nga faqja 7

te gjithe Programit te bashkeveprimt me Qeverine shqiptare dhe aktore te shoqerise civile.

Ne vijim, Kryetari i FSASH, Zoti Xhafer Dobrushi, ne emer te organizatoreve, lexoi Deklaraten e perbashket per Shtyp, ne te cilen, nder te tjera thuhet:

Qeveria shqiptare, shoqeria civile, sindikatat, partneret sociale, organizmat nderkombetare po zgjerojne bashkepunimin per t'i thene ndal punes se femijeve. Ne kushtet e Shqiperise, puna e femijeve perben nje teme te ndjeshme dhe te mprehte jo vetem per Qeverine dhe qeverisjen, por per te gjithe shoqerine, per te gjithe aktoret dhe operatoret e tjere te jetes ne vend.

Ne kuader te **Programit Kombetar "Mbi Eleminimin e Punes se Femijeve ne Shqiperi",** bashkepunim i Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta me Programin Nderkombetar per Eleminimin e Punes se Femijeve, (ILO/IPEC), qe nga viti 2002 jane bere analiza te fenomenit dhe jane hartuar e implementuar politika e programe per t'iu pergjigjur ketyre realiteteve.

Nje aspekt i rendesishem i Programit Kombetar ka qene Projekti "Sistemi i Monitorimit te Punes se Femijeve", i pilotuar ne 3 rajone: Tirane, Korçe dhe Berat, si nje bashkepunim i te gjithe aktoreve ne nivel lokal. Nepermjet tij u trajtuan mbi 400 femije dhe u arrit qe 54 femije te terhiqen nga puna dhe mbi 230 femije ne rrezik te mos braktisin shkollen dhe te mos perfundojne ne tregun e punes.

Keto arritje jane fryt i bashkepunimit te ngushte me te gjithe partneret, veçanerisht me Sindikatat e Arsimit, si ne nivel qendror edhe ne nivel lokal. Dy sindikatat e arsimit, FSASH dhe SPASH, prej 5 vjetesh jane angazhuar konkretisht ne trajnimin e me shume se 150 drejtuesve lokale e mesuesve, per njohjen e standardeve nderkombetare per mbrojtjen e femijeve dhe angazhimin e me shume se 1200 mesuesve ne punen individuale me nxenesit qe kane braktisur shkollen ose ne rrezik per ta braktisur. Deri tani eshte arritur te kthehen ne shkolle ose te nxirren nga rreziku i braktisjes se shkolles me shume se 2400 nxenes.

Deri me sot, Programi i ILO-IPEC ne Shqiperi ka ndihmuar drejtperdrejte 850 femije, te cilet i jane larguar punes se rruges apo aktiviteteve te paligjshme. Nepermjet Programit u eshte dhene mbeshtetje familjareve ne moshe pune, duke iu ofruar mundesi punesimi dhe kualifikimi profesional. Femijeve u eshte ofruar mesim ne klasa jo formale per te plotesuar boshlleqet si pasoje e mosfrekuentimit te shkolles.

Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta dhe Zyra e ILO/IPEC ne Shqiperi, sot ne Diten Nderkombetare Kunder Punes se Femijeve, kane kenaqesine te prezantojne dy projekte te reja: "Programi i integruar per eliminimin e punes dhe trafikimit te femijeve" dhe "Sistemi i Monitorimit te Punes se Femijeve". Zbatimi i projekteve do te shtrihet ne Tirane, Elbasan, Berat, Korce dhe Shkoder, duke parashikuar qe te asistohen rreth 650 femije te perfshire ne format me te keqija te punes. Grupi i targetuar do te jene femijet qe punojne ne rruge, bujqesi, sherbime dhe ata te perfshire ne trafikim ose/dhe aktivitete te paligjshme.

Per here te pare, ne bashkepunim me INSTAT, do te organizohet Studimi i Punes se Femijeve ne Shqiperi, qe pritet te sjelle nje informacion te sakte rreth permasave te fenomenit, shkaqeve qe e stimulojne dhe tendencat ne sektoret kryesore te ekonomise. Rezultatet e ketij studimi do te sherbejne per te hartuar politika dhe programe konkrete ne pershtatje me tendencat dhe permasat e fenomenit.

Ne emer te dy sindikatave te arsimit, FSASH e SPASH, Sekretari i Pergjithshem i FSASH, Stavri Liko, beri prezantimin mbi angazhimin e ketyre sindikatave, punen e bere, rezultatet e arritura dhe synimet e tyre per te kete vit e ne vijim, ku theksoi se mbi 1 200 mesues kane punuar konkretisht gjate ketyre tre kater viteve te fundit dhe jane duke vazhduar punen per shmangien e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve, duke rikthyer ne shkolle ose nxjerre jasht rrezikut te braktisjes se saj, mbi 2 400 nxenes, sidomos ne rrethet ku ato jane duke punuar ne kuadrin e zbatimit te Projektit qe ato kane me sindikatat holandeze, FNV/AOb.

Ne vijim, ai evidentoi eksperiencen e mesuesve te disa shkollave ne zonen e Kamzes ne Tirane; Levan, Roskovec, Zhupan e Mbrostar Ura ne Fier; "De Rada" e "Ptoleme Xhuvani" ne Elbasan; "28 Nentori", "Naim Frasheri" e disa shkolla te tjera ne Korce, dhe e vuri theksin tek domosdoshmeria e punes individuale me nxenes konkrete, perfshire edhe prinderit e tyre, duke angazhuar ne kete pune edhe bashkemoshataret e atyre nxenesve qe e kane braktisur shkollen ose jane ne rrezik per ta braktisur ate.

Evidentimi i praktikave te mira, synimet dhe objektivat e punes se sindikatave te arsimit dhe perfshirja e sindikatave te degeve te tjera ne angazhime konkrete per eliminimin e punes se femijeve, bashkepunimi me aktoret e tjere qe veprojne ne nivel kombetar e lokal, ishin, gjithashtu, pjese e prezantimit te paraqitur ne emer te FSASH e SPASH ne kete mbledhje.

Konkrete, interesante dhe mbreselenese ishin diskutimet qe bene nxenesja e shkolles se Bathores, Esmeralda Çala, mesuesja dhe drejtuesja sindikale nga Elbasani Bukuroshe Shabani, mesuesi Arqile Bitri nga shkolla e Levanit ne rrethin e Fierit, nxenesi nga Elbasani, Dylaver Celiku, nena e ketij nxenesi Albana Aliu, etj.

Perfaqesues te me shume se 15 kanaleve televizive ndoqen nga afer kete mbledhje dhe moren pjese ne Konferencen per shtyp qe u organizua ne kete kuader, duke transmetuar lajme dhe kronika me shume interes per opinionin publik, ne lidhje me Diten Boterore Kunder Punes se Femijeve.

Insistim per angazhimin e sindikatave te profesioneve te tjera kunder punes se femijeve

Takim i organizuar ne Tirane me drejtues te sindikatave te degeve e profesioneve te tjera

Ne kuadrin e 12 Qershorit, Dites Boterore Kunder Punes se Femijeve, dy sindikatat tona te arsimit, FSASH e SPASH, organizuan ne Tirane nje Takim me pjesemarrjen e drejtuesve te sindikatave te disa profesioneve, ne perberje te Bashkimit te Sindikatve te Pavarura te Shqiperise, BSPSH, dhe Konfederates se Sindikatave te Shqiperise, KSSH. Merrnin pjese, gjithashtu, drejtuesit kryesore dhe perfaqesues te tjere nga organet qendrore dhe ato lokale te FSASH e SPASH.



Ne emer te dy sindikatave te arsimit, Takimin e hapi, zoti Xhafer Dobrushi, i cili i njohu pjesemarresit me qellimin dhe programin e tij, duke e vene theksin tek zbatimi i detyrave qe kemi percaktuar se bashku per angazhimin e sindikatave shqiptare kunder punes se femijeve.

Ne vijim, Sekretari i Pergjithshem i FSASH, Stavri Liko, foli mbi Diten Boterore Kunder Punes se Femijeve, duke vene ne dukje se Organizata Nderkombetare e Punes, (ILO), e promovoi ate ne vitin 2002, si nje platforme per te nxjerre ne pah shtrirjen boterore te punes se femijeve dhe per t'u perqendruar ne veprime ne nivel boteror per eliminimin e saj. Çdo vit, kjo Dite lidh qeverite, punedhenesit dhe organizatat e punonjesve, si dhe shoqerine civile dhe te tjere, si shkolla dhe media, ne fushaten kunder punes se femijeve, nepermjet mbrojtjes dhe solidaritetit.

Pasi evidentoi disa nga detyrat e drejtperdrejta qe kane qeverite, institucionet arsimore dhe organizatat e shoqerise civile, ai permendi mbeshtetjen e Federates Nderkombetare te Arsimit, EI dhe te Zyres se ILO-IPEC ne Tirane dhe u ndale gjeresisht tek angazhimi i sindikatave, si nje faktor i rendesishem per eliminimin e punes se femijeve, si edhe tek pervoja e sindikatave te arsimit dhe rezultatet qe ato kane arritur ne kete drejtim.

Me tej, drejtuesit e FSASH e SPASH u ndalen hollesisht ne analizen e punes se bere dhe te detyrave konkrete qe dalin ne zbatim te Marrveshjes se Perbashket dhe Planit te Veprimit qe u miratuan ne Tryezen qe u organizua ne fund te muajit prill te ketij viti, duke terhequr edhe njehere vemendjen per domosdoshmnerine e ndermarrjes se veprimeve konkrete nga sindikatat e profesioneve te tjera, qofte edhe ne permasa te vogla fillimisht, por qe shenojne nje moment te rendesishem angazhimi qe mund te zgjerohet ne vijim me aktivitete me masive.

Kryetari i Federates Sindikale te Shendetesise, Z. Minella Mano, vleresoi punen e sindikatave te arsimit dhe rolin mbeshtetes te tyre edhe per sindikatat e tjera dhe pranoi se eshte e rendesishme qe secili te marre pergjegjesite e veta per mbrojtjen e femijeve dhe mbajtejn e tyre ne shkolle.

Kryetari i Sindikates se Pavarur te Ndertimit, Sherif Bulku, vuri ne dukje rolin e sindikatave te ndertimit per eliminimin e punes se femijeve ne kete sektor, qe eshte shume i demshem per femijet, jo vetem se pengon arsimimin e tyre, por edhe per faktin se eshte shume i rrezikshem edhe per shendetin e tyre. Ai theksoi gjithashtu se sindikata qe ai drejton ka filluar tashme nje fushate sensibilizimi kunder punes se femijeve ne kompanite e sektorit te ndertimit, duke shperndare mbi 1 000 fletushka, nepermjet te cilave behet thirrje per te mos lejuar femijet te punojne ne kete sektor.

Edhe drejtuesit e sindikatave te disa degeve te tjera si Qerim Ismeni, Liri Shehu, Riza Bengasi, vleresuan angazhimin e sindikatave te arsimit dhe u zotuan per perfshirjen e ceshtjes se elminimit te punes se femijeve ne axhenden e sindikatave qe ata drejtojne.

Pjesemarresve ne takim iu shperndane materiale propagandistike ne lidhje me Diten Boterore Kunder Punes se Femijeve dhe domosdoshmerine e arsimimit te femijeve, si kusht i rendesishem per zhvillimin progresiv te shoqerise.

Konferenca për rishikimin e reformës së projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim"

Në qytetin e Durrësit në hotel "Adriatik", u organizua konferenca e IV- të gjashtë mujore për rishikimin e reformës të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim". Në të morën pjesë përfaqësues të Bankës Boterore, PNUD, Bankës Evropiane për Zhvillim, Bankës Europiane të Investime, donatorë të tjerë të arsimit, Drejtore të Drejtorive e Zyrave Arsimore, Perfaqesuesit e Sindikatave Qendrore te Arsimit, etj.

Ne konference **Ministri i Arsimit, z.Genc Pollo** tha:

Ky takim periodik është bërë tanimë një ngjarje e shënuar për ne. Kështu na rijepet rregullisht rasti i mirë që të shqyrtojmë thellë dhe gjithanshëm arritjet dhe mosarritjet tona e të kuptojmë më mirë pikat tona të forta dhe ato të dobta, si dhe të jemi më të qartë për mundësitë e zhvillimit, edhe për rreziqet potenciale të tij.

Që në krye të fjalës sime, dëshiroj të falenderoj posaçërisht e të shpreh mirënjohjen e qeverisë shqiptare për kontributin e pazëvendësueshëm të të tri bankave, një kontribut shumëpërmasor, me ekspertizë të lartë dhe përkushtim shëmbullor.

Gjithashtu, falenderoj përzemërsisht Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë, Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë, Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD), ambasadat dhe agjensitë e ndihmës së Gjermanisë, Italisë, Austrisë, Zvicrës, Kinës, Japonisë, edhe të vendeve të tjera, si dhe UNICEF, Save the Children, Fondacionin Shoqëria e Hapur etj. për kontributet në realizimin e Strategjive Kombëtare të Arsimit.

Ne kemi qenë të gjithë të një mendje për një program reforme ambicioz sepse nuk mundemi të shtyjmë për më vonë ndryshimet e thella sistemike. Sfida jonë në përvijimin e planit të çdo viti, edhe të vitit 2008, mbetet gjetja e një baraspeshimi në mes NEVOJËS për një kompleksitet ndërrmarjesh reformuese dhe MUNDËSISË për t'i përballuar ato.



Ashtu si në vitin 2007, edhe këtë vit, kemi planifikuar bashkërisht reforma të tjera të cilat synojnë një hap më përpara në konsolidimin e një sistemi arsimor i cili të mundësojë:

Realizimin e potencialit maksimal të individit;

Përparimin e shoqërisë nëpërmjet aftësimit të qytetarëve për përfshirje aktive në ushtrimin dhe zhvillimin e demokracisë,

Mbarëvajtjen e ekonomisë së tregut të lirë nëpërmjet aftësimit të forcave të punës për të përballuar ritme të larta të rritjes ekonomike dhe të zhvillimit teknologjik.

Gjatë këtyre muajve të parë të këtij viti ne i kemi mëshuar sidomos dy drejtimeve themelore reformuese duke i konsideruar parakushte të suksesit. Këto janë:

Menaxhimi, Pjesëmarrja (participationvoice).

Neve na duhet të çrrënjosim kulturën e administrimit "nga lart-poshtë", me frymë komanduese, të ngurtësuar nga dhjetëravjeçarë administrimi autokratik dhe na duhet ta bëjmë krahas për të gjitha nivelet, nga ai qëndor deri në nivelin klasë.

Është një proces i vështirë, kryesisht në trajtën e "learning by doing", SËAP është ndihmesa e frytshme, dhe i kombinuar me një sërë reformash në fushën e menaxhimit, si dhe me trajnime të shumta kryesisht brenda vendit.

Ne po përpiqemi të instalojmë mentalitete dhe praktika bashkëkohore të cilat karakterizohen nga menaxhimi:

Mbi bazën e performancës, (Objektiva minimale të arritjeve të nxënësve për mësuesit, objektiva të matshme në planet vjetore të shkollave, tregues të performancës për institucionet),

Mbi bazën e treguesve të suksesit (Treguesit e shkollës së suksesshme janë të hartuar e pilotuara tanimë),

Mbi bazën e standardeve profesionale (Janë në përfundim standardet e drejtorit të shkollës, të mësuesit, trajnerit, të inspektorit dhe specialistit të DAR-it, si dhe kodi etik i mësuesit),

Mbi bazën e një procedure sitematike të raportimit, monitorimit, vlerësimit e vetëvlerësimit (Raportimet mujore të performancës nga drejtoritë e Ministrisë dhe institucionet qëndrore të varësisë tanimë janë kthyer në rutinore, është në përfundim drafti për ristrukturimin e inspektoriatit, formati i vetëvlerësimit në nivel shkolle, është në veprim një task force i cili siguron informacion plotësues për cilësinë e zbatimit të akteve reformuese dhe përmirësimin e tyre),

Nga ana tjetër, nëpërmjet trajnimeve, që janë kryer brenda këtyre pesë muajve, me të gjithë drejtorët e shkollave, me të gjithë inspektorët dhe me një pjesë të mësuesve e që do të vazhdojnë me të gjithë mësuesit, jemi përqëndruar në aftësimin e tyre për përvetësimin e një kulture moderne të menaxhimit.

Ndërsa në dy nivelet skajore, qëndor dhe shkollor, përpjekjet tona janë më intensive, mbetet ende niveli i ndërmjetëm, ai lokal, i decentralizuari dhe i dekoncentruari, tek të cilët përpjekjet për riformim të kulturës menaxheriale kanë pasur përgjithësisht efekt më të zbehtë.

Ndonëse që tani ne po prekim përmirësime, nuk presim rezultate të shpejta përfundimtare. Është ky një proces, i cili do të zgjatë. Ne do t'i kushtojmë vemendje konstante, duke e konsideruar vendimtar në suksesin afatgjatë të reformës.

Ndërsa përmirësimi i ndjeshëm i kulturës menaxhuese në administratën arsimore është themelore, përfshirja e gjerë e stakeholders në përvijimin e reformave, zbatimin e tyre, si dhe monitorimin e veprimtarive përkatëse është, gjithashtu, po aq me rëndësi në fatet e reformës. Këto janë dy anë komplementare dhe sinergjizuese.

Tanimë është kthyer në rutinë që qysh në skicat e parë të një akti reformues të konsultohemi me grupe të interesit, d.m.th. me mësues, drejtues shkollash, nxënës, prindër, me përfaqësues të sindikatave. Shume prej tyre pilotohen ose janë pilotuar prej kohësh falë bashkëpunimit me fondacione dhe organizata të huaja ose vendase.

Për skicat e para të akteve reformuese, tanimë është bërë si rregull që të hapen debate publike dhe profesionale në shtypin tonë. Gjithashtu, në grupet e punës që hartojnë dokumentat për këto akte reformuese janë të përfshirë përfituesit dhe zbatuesit e këtyre reformave, përsëri mësuesit, drejtuesit e shkollave, përfqësues të sindikatave, etj. Përmend vetëm që në hartimin e standardeve të arritjeve të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë kanë marrë pjesë me qindra mësues nëpër Shqipëri.

Nga ana tjetër, këto muaj kemi përparuar më shumë në "board approach" për të institucionalizuar zërin e grupeve të interesit.

Bordet e dy institucioneve qëndrore të varësisë, Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit dhe Agjensia e Vlerësimit të Arritjeve, janë ngritur, kurse bordi i shkollës, ende fillestar në rolet e reja të rëndësishme, po mbështetet me përparësi. Një trajnim i të gjithë kryetarëve të bordeve sapo ka përfunduar, ndërkohë që fuqizimi i tij do të vijë dhe nga funksione të tjera që po i atribuohen, siç është pjesëmarrja në emërimin e personelit shkollor.

Gjithashtu, statusi i një bordi lokal të arsimit, me përfaqësue nga njësitë lokale të decentralizuara e të dekoncentruara, tanimë është përvijuar dhe do të nisë nga puna që në fillim të vitit të ardhëm shkollor.

Ndërmjet veprimtarive të larmishme të këtyre pesë muajve po përzgjedh dy prej tyre, reformën e kurrikulës së arsimit të mesëm të lartë dhe në atë të arsimit profesional, duke i veçuar për shkak të impaktit

Vijon në faqen 12

Vijon nga faqja 10

të madh që pritet të kenë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor. Tek e fundit, janë një si terminal i të gjitha përpjekjeve tona për reformime.

Me këtë vit shkollor mbyllet reforma e kurrikulës e arsimit bazë e cila është përvijuar vite më parë. Megjithë përmirësimet e kryera, gjykimi i përgjithshëm është se nuk u arrit dot të kapet momenti për te krijuar një kurrikulë me karakeristika të dukshme bashkëkohore. Ne kemi programe lëndore (syllabuses) të reja për arsimin bazë, tekste të reja, ato janë përgjithësisht më të mira se të mëparshmet, por nuk shkuam deri në një brez të ri programesh dhe tekstesh e te një mësimdhënie-mësimnxënie moderne. Jemi përballë sfidës për ta bërë këtë tani, në arsimin e mesëm të lartë.



Tanimë, pas debatesh profesionale dhe publike, kemi vendosur për një strukturë të re të arsimit të mesëm të lartë, që zgjeron ndjeshëm larminë e itenerareve kurrikulare të nxënësve duke përmbushur kështu më mirë nevojat dhe interesat e tyre.

Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit ka marrë porosinë zyrtare nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për hartimin e kurrikulës së re e cila karakterizohet nga disa zhvendosje thelbësore:

Nga një kurrikulë me ndarje thuajse të izoluara ndërmjet lëndëve në një kurrikulë ku linjat integruese do të jenë përparësore,

Nga një kurrikulë me mbizotërim të fakteve në atë me mbizotërim të koncepteve, metodave, aftësive dhe qëndrimeve,

Nga një mësimdhënie me mbizotërim të verbalizmit dhe të mësuarit mekanik, në një tjetër ku mbizotërojnë aftësitë e të nxënit gjatë gjithë jetës, të menduarit kritik dhe krijues,

Nga një kurrikulë pastër akademike, në një tjetër ku life-skills marrin rëndësi parimore.

Grupet e specialistëve dhe të mësuesve po punojnë intensivisht dhe janë në përfundim të hartimit të bazave të kurrikulës së re.

Reforma e kurrikulës së arsimit profesional është po aq rrënjësore.

Tanimë, pas debatesh profesionale dhe publike, kemi vendosur për një strukturë të re të arsimit profesional publik, e cila bazohet në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe draft-Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional ka marrë porosinë zyrtare nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për hartimin e kurrikulës së re e cila karakterizohet nga disa risi thelbësore, të cilat do të bëjnë arsimin profesional më të dobishëm për tregun dhe më tërheqës për nxënësit.

Këto risi thelbësore janë:

Një strukturë tre-nivelëshe (ndihmës - punonjës i kualifikuar – teknik/mamaxher) me tri herë mundësi daljeje në tregun e punës,

Kurrikulë dy-nivelëshe, qëndror dhe shkollor, me fleksibilitet përshtatjeje ndaj kërkesë-ofertës së tregut rajonal,

Një sistem modular për aspektet praktike mësimore.

Tanimë Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional ka përfunduar draftin e kurrikulës së arsimit profesional publik, një përshtatje në kushtet tona të zhvillimeve ndërkombëtare dhe modeleve që janë provuar përgjatë disa viteve te ne dhe po piloton kurrikulën e re në nivelin qëndror për dy drejtime profesionale, teknologji ushqimore dhe ndërtim.

Sigurisht që nuk janë aspak të lehta të dyja këto reforma madhore, por janë të domosdoshme. Mbarëvajtja e tyre detyron zhvillime të tjera paraprake kryesisht kah autonomia shkollore, gjithashtu dhe sidomos, përgatitje të shëndoshë të kapaciteteve profesionale.

(Marre me shkurtime nga Gazeta " Mesuesi"

Takim i rendesishem me perfaqesues te DAR e ZA te Qarkut te Elbasanit

Ne vijim te aktiviteteve per forcimin e partneritetit social me Drejtorite Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, keto dite u zhvillua nje takim i rendesishem ne Qarkun e Elbasanit, ku pervec Drejtorit te DAR te ketij Qarku, Z. Kujtim Mema, merrnin pjese drejtues e perfaqesues nga Zyrat Arsimore te rretheve Librazhd, Gramsh e Peqin.

Moren pjese, gjithashtu, drejtuesit e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, dhe perfaqesues te tjere te organeve qendrore e lokale te ketyre sindikatave

Ne emer te te dy sindikatave, zoti Xhafer Dobrushi paraqiti mendimet e propozimet ne lidhje me zgjerimin e partneritetit midis te dy institucioneve, DAR e ZA, nga njera ane dhe seksioneve perkatese sindikale te arsimit, nga ana tjeter. Pasi vleresoi institucionalizimin e ketyre mardhenieve nepermjet Kontrates Kolektive te Punes, ai vuri ne dukje perpjekjet qe po bejne te dyja sindikatat, jo vetem per mbrojtjen e interesave social - ekonomike te anetareve, por edhe per te kontribuar drejtperdrejt ne zhvillimin cilesor te arsimit, kualifikimin e mesuesve, uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve.

Kryetari i SPASH-it, Z. Bajram Kruja dhe perfaqesuesit e tjere te sindikatave vleresuan, gjithashtu, angazhimin e Drejtorive Arsimore dhe administratave te shkollave per aktivitetet qe kane ndermarre sindikatat e arsimit. Ata kerkuan forcimin e metejshem te bashkepunimit midis te dy paleve, sidomos duke perdorur me mire mesuesit e trajnuar nga sindikatat, materialet qe ato kane botuar si edhe motivimin me te mire te mesuesve qe jane te angazhuar mbi kohen normale te punes dhe kane rezultate te mira ne punen individuale me nxenesit qe kane braktisur ose jane ne rrezik per ta braktisur shkollen, duke perdorur me mire dhe me me efikasitet edhe buxhetin e Fondit te Vecante.

Vemendje te vecante terhoqen ne Takim ceshtjet qe lidhen me zbatimin e detyrimeve ligjore qe kane Drejtorite dhe Zyrat Arsimore per kryerjen e veprimeve financiare, ne lidhje me zbritjen e kuotes se anetaresise se mesuesve anetare te FSASH e SPASH, nga liste pagesat e pagave. Drejtuesit e sindikatave sqaruan kuadrin ligjor te ketij veprimi financiar, bazuar ne Kodin e Punes dhe Kontraten Kolektive te Punes, ku perfshihen listat e rregullta te anetaresise te firmosura nga secili prej anetareve, ne te cilat theksohet se pranohet mbajtja e kuotes se anetaresise, duke e zbritur ate nga borderoja perkatese.

Ne Takim u theksua domosdoshmeria e pergjegjesise se seciles prej paleve per zbatimin e detyrimeve qe kane ndaj njeratjetres, sidomos ne lidhje me zbatimin e Kontrates Kolektive te Punes, kryerejn e reformes dhe zhvillimin cilesor te sistemit arsimor ne vendin tone.

Zoti Kujtim Mema dhe perfaqesuesit e tjere te DAR e ZA-ve vleresuan punen e sindikatave ne rrethet perkatese, por nderkohe kerkuan nje kordinim me te mire ne te ardhmen, sidomos persa u perket problemeve qe lidhen me organizimin e aktiviteteve te perbashketa dhe rritjen e rolit e te pergjegjesise se drejtuesve te seksioneve sindikale ne rrethe dhe te drejtuesve sindikale ne shkolla.

Diskutimet ishin konstruktive dhe secila prej paleve mori pergjegjesite e veta per forcimin e metejshem te partneritet real midis tyre, ne funksion te mbrojtjes se interesave te mesuesve dhe zhvillimit cilesor te arsimit ne vendin tone.

Pjesemarresit ne takim u pajisen me materiale te shumta, te botuara nga FSASH e SPASH, perfshire edhe Modulet SCREAM, Manualin mbi Arsimin Jo-Formal, botimet e fundit te Revistes «Tribuna Sindikale » etj.

Stavri LIKO

Te rritet me tej roli i gruas ne Arsim dhe ne Sindikate

Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH

Me 6 qershor, sipas miratimit te veprimtarise se SPASH per vitin 2008, u zhvillua mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH me teme ; "Roli i gruas ne Arsim dhe ne sindikate". Raportin, ne emer te Kryesise e mbajti Znj. Bukuroshe Shabani, ZV Kryetare e SPASH dhe Kryetare per Qarkun e Elbasanit.

Ne fjalen e saj Znj. Bukuroshe sqaroi disa konkluzione te nxjera nga anketimi ne bashkepunim me FSASH dhe me mbeshtetjen e sindikatave holandeze FNV dhe AOb mbi punen me grate mesuese. Ne 65 shkolla qe eshte kryer anketimi punojne 2 463 mesues prej te cileve 1965 jane gra. Pra grate perbejne afer 80% te numrit te pergjithshem te mesuesve.

Ne vijim raporti i beri nje analize te hollesishme konkluzioneve mbi: - poziten e grave ne administrate dhe ne organet drejtuese te SPASH, - mardheniet e punes dhe qendrimin e komiteteve ne shkolla e ne rrethe, - problemet sociale e te kohes lire te grave, - mendimet qe kane grate mesuese per sindikatat dhe per rolin e grave ne sindikate, - mendimet qe kane drejtuesit e shkollave per sindikatat dhe rolin e grave ne forumet e tyre etj.

U theksua, gjithashtu, se se ne disa shkolla, ne bordet e tyre nuk i pranojne perfaqesuesit e sindikates. Kjo nuk eshte e drejte, sepse ne jemi ne rolin e punemarresit dhe mbrohemi nga Kushtetuta, nga Kodi i Punes, nga Kontrata Kolektive e firmosur nga Z Genc Pollo, si punedhenes, dhe per ato qe jane firmosur ne kerkojme zbatimin.

Znj Bukuroshe ne mbyllje te fjales saj, beri thirje per nje angazhim me te te mire te grave mesuese per te zhvilluar ne cdo rreth aktivitete ne kuader te Dites Boterore Kunder Punes se Femijve.

Ne ceshtjen e dyte te rendit te dites e mori fjalen Z Defrim Spahiu, i cili lexoi materialin e paraqitur ne mbledhjen e Keshillit Kombetar te Punes zhvilluar me 5 qershor, me teme: « Funksionimi i partneritetit social ne te gjitha nivelet e sektorit te arsimit », pergatitur nga Z XH.Dobrushi e Z B. Kruja.

Ne diskutimet e perfaqesuesve te rretheve te ndryshme u dhane vleresimet dhe mendimet per te dyja ceshtjet.

Ne fund Keshilli Drejtues ngriti disa ceshtje si;

- SPASH, ne kuader te BSPSH, nuk mbeshtet kerkesen e FMN per rritjen e cmimit te energjise elektrike per vitin 2008,

- SPASH nuk pranon te diskutohet "kerkesa" per ritjen e moshes se pensionit por eshte dakord per permiresimin e kesaj qe po zbatohet,

- SPASH vazhdon te jete dakord me rritjen e pagave edhe me 14 % per kete vit, duke shpresuar qe ne fund te vitit te ardhshem pagat do te dyfishohen, krahasuar me ato te fillim vitit 2005.

Z. Bajram Kruja beri disa sqarime nelidhje me keto probleme dhe u ra dakorte qe, se bashku me Z. Xhafer Dobrushi te meret nje takim me Z. Genc Pollo per shqetesimet e fillimin e vitit te ri shkollor.



Të reja shkencore

AVENTURA E KYÇEVE

Protezat në këmbë mund të jenë të vështira për t'u përdorur dhe e bëjnë ecjen të vështirë dhe të ngathët. Por "PowerFoot One" është pajisja e parë me bateri që lehtëson përdoruesin e saj të ecë përpara dhe bën të mundur një ecje më natyrale. Mikroprocesorët dhe sensorët specialë, të



vendosur në brendësi të saj, bëjnë që kjo pajisje të ndihmojë shumë në ngjitjen e pjerrësive dhe shkallëve. E krijuar nga Hugh Herr, një Profesor me të dyja këmbët të aksidentuara, "PowerFoot One" rifiton energji me çdo hap që kryhet.

MINJTE E DOBISHËM

Krijimi i një modeli miu për ta përdorur për shërimin e një sëmundje është thelbësor për të ndihmuar kërkuesit të kuptojnë si zhvillohet ajo. Shkencëtarët në Johns Hopkins kanë krijuar një



model miu që shfaq ndryshimet në tru dhe simptomat e mënyrës së të sjellurit te skizofrenia. Miu ka vetëm një formë të lehtë të sëmundjes, por do të ndihmojë shumë për të zbuluar faktorët e ndërlikuar që kontribuojnë për çrregullimet mendore.

MREKULLITË MODERNE

Imagjinoni një shtëpi të madhe me ngrohje dhe ftohje falas. Sistemi i Ndërtimit i Mike Sykes mbështetet në mure të trashë prej druri dhe rrymat e qarkullimit të ajrit, madje edhe në temperatura ekstreme.

Dy milion transistorë në një mikrocip pothuajse të padukshëm

Inxhinierët elektronikë vazhdojnë të jenë skllevër të Ligjit Moore, sipas të cilit: Ata duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që të " paketojnë" sa më shumë fuqi pa ndryshuar madhësinë e mikrocipeve.



Në këtë përpjekje, ata kanë bërë një shpikje tjetër me një material të ri që shmang rrjedhjen e energjise, që është një problem i madh me zvogelimin e masës së transistorëve. Procesori më i ri, me permasa vetëm 45 nanometer, (0, 000 000 001 e metrit), është aq kompakt sa mund të përmbajë 2 milion transistorë, një arritje kjo sumë e rëndësishme në fushën e elektronikës aktuale.

Këshilla praktike

Tetë pyetje që duhet t'i bëni eprorit tuaj

Me siguri keni një sërë pyetjesh që do të donit t'i bënit eprorit tuaj, nëse ju jepej mundësia, si për shembull:

Vërtet keni paguar për atë prerje flokësh?

Është e thënë që dreka juaj të përmbajë gjithmonë hudhër?

Si mund dikush si ju të jetë martuar me një person kaq të pakëndshëm?

Nëse dëshironi sadopak të vazhdoni të qëndroni në punë do t'i mbanit këto pyetje për vete. Fatkeqësisht punonjësit kanë tendencën t'i mbajnë të gjitha pyetjet për vete, edhe nëse e kundërta do t'i ndihmonte në rritjen në detyrë.

Ja tek janë tetë pyetje që do t'ju ndihmonin në karierën tuaj, (vetëm mos i bëni të gjitha në të njëjtën kohë, eprori juaj ka shumë mundësi të jetë i zënë edhe me punë të tjera).

Si e masni suksesin?

Punonjësit shpesh harrojnë që performancat e tyre vlerësohen, në një mënyrë apo në një tjetër. Për të kuptuar si vlerësohet puna juaj, duhet të flisni të njëjtën gjuhë si eprori juaj. Zbuloni nëse menaxheri juaj është i interesuar në shifra dhe rezultate apo nëse mënyra si i arrini ato është gjithashtu e rëndësishme. Më pas përshtatni punën tuaj me prioritetet e tij.

Në çfarë fushash duhet të përqëndrohem që të avancojë në karierë?

Kjo pyetje i tregon eprorit tuaj se jeni në kontroll të të ardhmes suaj dhe nuk po prisni për diçka nga qielli. Nëse flisni për qëllimet tuaja, eprori mund t'ju tregojë eksperiencën që ju nevojitet për t'u ngjitur në shkallët e suksesit.

Cilat janë pikat e forta që do të më ndihmonin në karierën time?

Mos u përqëndroni për të parë dobësitë tuaja duke harruar pikat e forta. Ju mund të mendoni që i dini pikat tuaja të forta dhe të dobëta, por eprori mund të mendojë ndryshe. Kjo pyetje nuk është një justifikim për të marrë një kompliment, është një mundësi për t'i treguar eprorit që dëshironi të "ngisni" karierën tuaj.

Kur kryhen vlerësimet e performancave dhe kush është në ngarkim për të?

Pyetje elementare si kjo janë thelbësore për performancën tuaj. Të kuptuarit e mekanizmit të punës suaj duhet të jetë një prioritet i lartë në cdo kohë. Sigurohuni të mësoni nëse keni qëllime vjetore për të synuar dhe si përfshihen ato në detyrat tuaja të përditshme.

Çfarë mundësirash për rritje më ofrohen brenda kompanisë?

Edhe pse mund të prisni që kjo pyetje të bëhet vetëm në intervista pune, është e vlefshme të pyesësh, edhe pse mund të jeni të punësuar që prej disa vitesh. Strukturat e kompanive ndryshojnë vazhdimisht dhe duhet të mësoni çfarë mundësish janë hapur, nëse dëshironi të avanconi në karierë. Pasi të dini cilat janë mundësitë, mund të vendosni lëvizjet tuaja.

E kuptova mirë?

Kur keni një projekt që ka shumë përbërës ose udhëzime të reja, sigurohuni që e dini mirë cila është detyra juaj. Trajtimi i një detyre pa e ditur se jeni në rrugën e duhur lë hapësirë për një surprizë të pakëndshme ditën kur duhet të bëhet dorëzimi. Kontrolloni gjithçka me eprorin tuaj për të siguruar që keni kuptuar mirë. Nëse nuk bëni pyetjen e duhur, mund të ktheheni mbrapsht në karierën tuaj, megjithëse jeni tërësisht në gjendje të kryeni punën. Kufizojeni pak veten kur bëni këtë pyetje. Asnjë shef nuk do të përsërisë gjithçka shumë shpesh.

Çfarë mund të bëj për t'ju ndihmuar?

Kjo pyetje e thjeshtë është e rëndësishme por shpesh harrohet. Edhe nëse nuk mund të ndihmoni, eprori do ta vlerësojë ofertën tuaj.

Cili është prioriteti më i rëndësishëm në të cilin duhet të përqëndrohemi?

Kjo pyetje shpesh nuk bëhet sepse punonjësit kanë frikë se mund të duken të pa aftë. Në fakt kjo tregon që jeni të interesar për përgjegjësitë dhe qëllimet e grupit tuaj.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

TRIBUNA SINDIKALE



